

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Lidhur në Tranë, sot, më 15.05.2022, ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: Znj. Efthymia Gkouma, shtetase greke, e bija e Vasileios liqdur 30.10.1969 në Selanik Gregi dhe banuese në adresën: 26 Octovriou 46, N.Menemeni, Thessaloniki, T.K. 56122, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr. AK304727, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar (më tej referuar si "Shitësi").

BLERËSI: Media A.B.C. Holding BV, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar bazuar në të drejtën e Mbretërisë së Holandës, me seli në: Strawinskylaan 1431, 1077 XX Amsterdam, The Netherlands (Holandë), e regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë së Amsterdimit me numër KVK: 85264679, e me anëtar te vetëm te Bordit, Dutch Trust Managment BV përfaqësuar nga Znj.Dorina Zhuka me Prokurën nr.1560 datë 13.04.2022 (më tej referuar si "Blerësi") (së bashku referuar si "Palët")

BAZA LIGJORE: Nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

DEKLARIME PARAPRAKE

- Shitësi është themeluesi dhe ortak i vetëm, zotërues i kuotës së vetme të shoqërisë "A.B.C. MANAGEMENT" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës shqiptare, regjistruar pranë QKB me NUIS L91911028V, me seli në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga "Aleksander Moisiu", Ish Godina Kinostudio (më tej referuar si "Shoqëria").
- Shitësi kërkon të shesë 100% (njëqind përqind) të

SHARE PURCHASE AGREEMENT

Entered into today, on 15.05.2022, between the following parties:

SELLER: Mrs.Efthymia Gkouma, of Greek citizenship, daughter of Vasileios, born on 30.10.1969 in Thessaloniki, Greece and a resident in the address: 26 Octovriou 46, N.Menemeni, Thessaloniki, T.K. 56122, identified by ID nr.AK 304727, adult, enjoying full legal capacity to act (hereinafter referred to as the "Seller").

BUYER: Media A.B.C. Holding BV, a limited liability company founded based on the laws of the Kingdom of the Netherlands, based in Strawinskylaan 1431, 1077 XX Amsterdam, The Netherlands, registered at the Amsterdam Chamber of Commerce with KVK number: 85264679, with Dutch Trust Management BV as sole Board member, represented by Mrs. Dorina Zhuka, through a POA 1560, dated 13.04.2022 (hereinafter referred to as the "Buyer") jointly referred to as the "Parties")

LEGAL BASIS: Articles 705 et seq. of the Civil Code of the Republic of Albania (as amended), articles 73-75 of the law no. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies" (as amended).

PRELIMINARY DECLARATIONS

- The Seller is the sole founder and shareholder, owner of the sole share of "A.B.C. MANAGEMENT" LLC, a limited liability company based on the Albanian law, registered at the National Business Center with NUIS number L91911028V, based in Tirana, Albania, at the address: Rruga "Aleksander Moisiu", Ish-Godina Kinostudio (hereinafter referred to as "Company").
- The Seller wishes to sell 100% (one-hundred percent)

Page / Faqe 1 of / nga 7

kuotës së tij dhe Blerësi është i interesuar ta blejë atë.

3. Me vendimin Asamblesë së Përgjithshme të Partnerëve, apostiluar me nr. 15801 datë 08.04.2022, në Amsterdam, Holandë, Blerësi ka miratuar blerjen e 100% (njëqind përqind) të kuotës sipas kushteve të kësaj kontrate.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacenuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e Kuotës që Shitësi zotëron në shoqërinë "A.B.C. MANAGEMENT" SHPK (më tej referuar si "Kontrata"), me kushte si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e 100% (njëqind përqind) të Kuotës nga Shitësi në favor të Blerësit.

NENI 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës është në vlerën EUR 100 (njëqind euro) neto dhe është paguar nga Blerësi në favor të Shitësit *cash* në momentin e hartimit të kontratës.

NENI 3

Kalimi i pronësisë mbi kuotën

- 3.1 Blerësi bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapitalin bazë të shoqërisë me nënshkrimin e kontratës.
- 3.2 Regjistrimi i Kontratës pranë institucioneve përgjegjëse (si për shembull: Qendra Kombëtare e Biznesit) do të ketë funksion deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi kuotën në momentin e përcaktuar në nenin 3.1 më sipër, pavarësisht momentit se kur kjo Kontratë

of his share and the Buyer is interested in purchasing it.

3. With Resolution of the General Assembly of Partners, apostilled no. 15801 date 08.04.2022, in Amsterdam Netherlands, the Buyer has approved the purchase of 100% (one-hundred percent) of the Share as per the terms of this Contract.

Therefore, the Parties with their full, free and unviced will, decide to enter this Contract on the Sale of the Share that the Seller owns at "A.B.C. MANAGEMENT" LLC (hereinafter referred to as "Contract"), subject to the following terms.

ARTICLE 1

Object

- 1.1 The object of this Contract is the sanctioning of the terms, modalities and consequences of the transaction on the sale of 100% (one-hundred percent) of the Share from the Seller to the Buyer.

ARTICLE 2

Purchase price and payment method

- 2.1 The net purchase price of the Share amount to EUR 100 (one-hundred euros) and has been paid in cash by the Buyer in favor of the Seller at the moment of the drafting of this contract.

ARTICLE 3

The transfer of ownership over the Share

- 3.1 Upon signing this Contract, the Buyer becomes the owner of 1 (one) share, which gives the right to participation by 100% at the capital of the company.
- 3.2 The registration of the Contract at the competent authorities (for example: the National Business Center) shall have a declarative function in regards to third Parties and the Buyer gains ownership over the Share at the moment specified in article 3.1 above, regardless of when this Contract is

regjistrohet dhe publikohet pranë institucioneve përgjegjëse.

NENI 4

Pasojat e shitjes së kuotës

- 4.1 Palët bien dakord se si pasojë e shitjes së kuotës, Shitësi nuk do të jetë më ortak në Shoqëri dhe ortak i vetëm i saj do të bëhet Blerësi, i cili do të zotërojë 1 (një) kuotë që jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% (njëqind përqind) në kapitalin bazë të shoqërisë, si dhe të drejtat e detyrimit e saj.
- 4.2 Çdo e drejtë apo detyrim i Shitësit në lidhje me shoqërinë, i cili daton përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate do të mbetet ekskluzivisht i tij.

NENI 5

Garancitë e Palëve

- 5.1 Shitësi garanton Blerësin se:
- 5.1.1. Zotëron 100% të Kuotës së Shoqërisë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të saj bazë, i cili është në vlerën 100 (njëqind) lekë. Kuota në tërësinë e saj nuk është subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve; Kuota e Shoqërisë gjithashtu nuk është subjekt i barre reale apo juridike.
- 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.1.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate.
- 5.1.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;

registered and published at the competent authorities.

ARTICLE 4

The consequences of the sale of the share

- 4.1 Parties agree that as a result of the sale of the Share, the Seller will no longer be a shareholder of the company, and the Buyer, who shall own 1 (one) share, which gives the right to participation by 100% (one-hundred percent) at the capital of the company, as well as its rights and obligations, shall become its sole shareholder.
- 4.2 Every right and obligation of the Seller related to the Company, dating prior to the signing of this Contract, shall remain exclusively his.

ARTICLE 5

Guarantees of the Parties

- 5.1 The Seller guarantees the Buyer that:
- 5.1.1. He owns 100% of the Shares of the Company, which represents 100% of its capital, which amounts to 100 (one-hundred) Lekë. The Share in its entirety is not subject to sequestration, prohibition of sale, pre-emptive rights, bank guarantees, or any other mean securing the performance of obligations; the Share of the Company is also not subject to any real or legal burden.
- 5.1.2. Has the right, ability and full capacity to decide on the sale of the Share and to perform this contract as per its terms, without needing any preliminary approval of any other person, be that a natural or legal one;
- 5.1.3. Has undertaken and shall undertake any necessary legal actions for the authorization, performance and registration of this Contract.
- 5.1.4. The performance of this contract shall not result in any situation of illegality, unlawfulness or avoidance, related to the Contract *per se*, the Acts of Incorporation of the Company, obligation relations between the company and third parties or the Seller and third parties, or the law in

5.1.5. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë;

5.1.6. Shoqëria nuk ka asnjë detyrim apo përgjegjësi të papërbushur me përjashtim të atyre të reflektuara në Bilancin Vjetor të vitit 2020 dhe pasqyrat më të fundit financiare;

5.2 Blerësi garanton Shitësin se:

5.2.1 Blerja e 100% të kuotës është në përputhje me vullnetin e tij;

5.2.2 Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;

5.2.3 Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;

5.2.4 Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;

5.2.5 Vlera monetare e përdorur për blerjen e kuotës sipas kontrate është krijuar si pasojë e veprimtarisë së ligjshme.

5.2.6 Blerësi nuk është subjekt i ndonjë procesi penal lidhur me veprimtarinë e tij.

NENI 6

Pagesat lidhur me ekzekutimin e kësaj Kontrate

6.1 Të gjitha pagesat lidhur me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbarten nga Shitësi.

NENI 7

Konfidencialiteti

7.1 Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohen në përputhje me

force;

5.1.5. No third natural or legal person has any rights over the Share or capital of the Company;

5.1.6. The Company does not have any unperformed obligation or responsibility except for those reflected in the 2020 yearly Balance Sheets and the most recent financial books;

5.2 The Seller guarantees the Buyer that:

5.2.1 Purchase of 100% of the Share is in accordance with his will;

5.2.2 Has the full right, ability and capacity to decide to purchase the Share and to execute this Contract according to its provisions, without the need for the prior consent or approval of any other person, whether natural or legal;

5.2.3 Has undertaken or will undertake all necessary legal actions for the authorization, execution and registration of this Contract;

5.2.4 Fulfillment of this contract will not result in a situation of counter legality, illegality or invalidity, related to the Contract itself, relationship of obligations between the Buyer and third parties, or the legislation in force;

5.2.5 The monetary value used for the purchase of the share under the contract is created as a result of legal activity.

5.2.6 The buyer is not subject to any criminal proceedings related to his activity.

ARTICLE 6

Payments related to the execution of this Contract

6.1 All payments related to the execution and registration of this Contract will be borne by the Seller.

ARTICLE 7

Confidentiality

7.1 The Parties agree that this Contract and any pre-

parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.

7.2 Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:

7.2.1. Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;

7.2.2. Transmetimi bëhet në kuadër të përmbushjes së një detyrimi;

7.2.3. Transmetimi i bëhet një këshilltari të shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit (p.sh. Avokatit, ekspertit kontabël);

7.2.4. Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;

7.2.5. Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;

7.2.6. Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;

7.2.7. Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

NENI 8

Komunikimi ndërmjet palëve

8.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në adresat dhe e-maillet e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.

8.2. Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i

contractual negotiation will be treated in accordance with the principle of confidentiality and that it will not share any data or information regarding each other's commercial, financial or legal relations, and that it will not make no statement regarding the existence, object or provisions of this Contract.

7.2 The parties are exempted from the obligation to maintain confidentiality in case:

7.2.1 The other party has given consent for sharing the data;

7.2.2 Sharing takes place in the framework of the fulfillment of an obligation;

7.2.3 Sharing is made towards a company advisor, who is subject to the obligation to maintain confidentiality (e. g. lawyer, chartered accountant);

7.2.4 It is necessary to perform a legal duty of public interest or to exercise a competence of the Party sharing the information or of a third party to whom the data have been disseminated;

7.2.5 Need to pursue the legitimate interests of the party sharing the information or of a third party to whom the data has been disseminated;

7.2.6 This data is made public by the other party and is located in the public domain and / or is accessible by third parties;

7.2.7 This data has been made public or made known to the party sharing the data from third parties.

ARTICLE 8

Correspondence between the parties

8.1 All communications between the parties, as well as the requests they have to each other, will be made in writing or via e-mail, to the addresses and e-mails specified by the parties in the part regarding their generalities.

8.2 In the event that the above persons and/or

pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.

- 8.3. Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 7.2 i kësaj Kontrate.

NENI 9

Interpretimi i kontratës

- 9.1. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 9.2. Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifikisht, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 dhe pika 1 e nenit 88 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

NENI 10

addresses and / or e-mails undergo changes, the Party undergoing them has the obligation to notify the other party within 24 hours from the moment of the change. Otherwise, any communication to the previous address will be considered valid even though it may not have been received by the Party that changed the contact person and/or the address and/or e-mail.

- 8.3 Any communication between the parties is confidential and shall not be shared directly or indirectly to third parties except in the cases provided for in Article 7.2 of this Contract.

ARTICLE 9

Contract Interpretation

- 9.1 The conditions set out in this contract are interpreted without stopping in the literary sense of the words, but taking into account the true purpose of the parties, which has pushed them into signing this contract. The terms of the contract are interpreted through each other, giving each one the meaning that comes from the entirety of the act. In case of doubt, the contract or its terms are interpreted in the sense in which they may have any effect and not in the sense in which they would have no effect.
- 9.2 The applicable law for the interpretation of this Contract shall be the legislation in force in the Republic of Albania, more specifically, articles 705 et seq. of the Civil Code, as amended, as well as articles 73-75 and point 1 of article 88 of the law no. 9901, dated 14.4.2008 "On entrepreneurs and companies", as amended.

ARTICLE 10

Settlement of disputes

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 10.2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 11 Forca madhore

- 11.1. Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmbytjet ose grevat.
- 11.2. Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

NENI 12 Të tjera



- 10.1 All disputes that may arise between the Parties regarding this Contract, the parties should try to resolve them amicably.
- 10.2 If no agreement is reached, the Contract will be subject to judicial review and the Tirana Judicial District Court will be competent to resolve the dispute.

ARTICLE 11 Force Majeure

- 11.1 For the purpose of this contract, "Major Force" means an event that is not caused and is beyond the reasonable control of one of the parties to this Contract, which causes the fulfillment of the obligations of the party in this contract to become either impossible, or so impractical enough to be reasonably considered impossible given the circumstances. It includes among others, epidemics, pandemics, conditions of natural disaster, war, civil disobedience, storms, floods or strikes.
- 11.2 In cases where there are conditions of Force Majeure, the deadlines provided in this contract for the execution of obligations may be extended if necessary for as long as the Major Force lasts. Major Force does not include insufficient funds or non-payment of a payment to be made under the contract.

ARTICLE 12 Others

12.1. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim

12.2. Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:

12.2.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;

12.2.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar për Blerësin;

12.2.3. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë;

12.2.4. Prokurë përfaqësimi për Dorina Zhila apostiluar me nr. 15801 datë 08.04.2022, në Amsterdam, Holandë;

12.2.5. Vendim i bordit të Blerësit, datë 23.03.2022.

12.3. Kjo kontratë përbëhet nga 7 (shtatë) faqe dhe është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë, një për tu regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe një për tu arkivuar nga Shoqëria.

12.4. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

12.1. Any amendment to this Contract is made by mutual consent of the parties and will be valid only if made in writing.

12.2. Attached and integral part of this Contract are:

12.2.1. Copy of the identity card of the signatory parties;

12.2.2. Commercial register extract of the Buyer;

12.2.3. Commercial register extract of the Company;

12.2.4. Power of attorney to Dorina Zhila apostilled no. 15801 date 08.04.2022, in Amsterdam, Netherlands;


12.2.5. Resolution of the Board of the Buyer, dated 23.03.2022.

12.3. This contract consists of 7 (seven) pages and is drafted in 4 (four) original copies in Albanian language, one for each party, one to be registered with the National Business Center and one to be archived by the Company.


12.4. This contract enters into force upon its signing .

PALËT: / PARTIES:

Shitësi: / Seller:


Znj/Mrs. Efthymia Gkouma

Blerësi: / Buyer:


Për "Media A.B.C. Holding BV": / For
"Media A.B.C. Holding BV":